



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, E TRANSPORTIT  
DHE E TELEKOMUNIKACIONIT

# **Plani i Integruar i Ministrisë 2008**

Shkurt 2008

## Mesazhi i Ministrit



Të nderuar qytetarë,

Plani i Integruar i Ministrisë është një dokument në të cilin përmbledhen angazhimet e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit gjatë vitit 2008, në kuadër të zhvillimit të të gjithë sektorëve të veprimtarisë së saj. Përmes këtyre angazhimeve ne do të synojmë përmbushjen e objektivave të përcaktuara në Programin e Qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian dhe anëtarësimi në NATO, realizimi i të cilave mbështetet tërësisht në Programin Buxhetor Afatmesëm 2008-2010.

Hartimi i këtij plani synon të mbështesë përpjekjet tona për të arritur një zhvillim ekonomik-social që do të ndikojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë.

Synimi kryesor i zhvillimit të sektorit të transportit është integrimi i rrjetit rrugor shqiptar në atë rajonal dhe evropian, duke përsheptuar ritmet e zbatimit të projekteve të infrastrukturës së transportit me impakt kombëtar, rritjen e standarteve të sigurisë rrugore, përmirësimin e kushteve që do të mundësonin lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mallrave.

Decentralizimi dhe komercializimi i sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, si dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit në këtë fushë do të jenë një tjetër drejtim i rëndësishëm ku do të fokusohet puna jonë gjatë vitit 2008.

Po ashtu hapja e tregut të telekomunikacioneve dhe të teknologjisë së informacionit do t'i hapë rrugën rritjes së investimeve private në këtë sektor, rritjes së aksesit në shërbime dhe rritjes së cilësisë së këtyre shërbimeve për konsumatorët.

Hartimi i ligjit për planifikimin hapësinor në Shqipëri do të synojë përfaqësimin e integruar dhe gjithëpërfshirës që kalon përtej urbanizimit dhe menaxhimit të tokës, të cilat kanë drejtuar planifikimin në Shqipëri gjatë viteve të fundit, duke marrë parasysh çështje dhe objektiva sociale, ekonomike si dhe mjedisore. Kjo do të përfshijë koordinim domethënës sistematik vertikalisht brenda sektorit publik - ndërmjet niveleve të

qeverisjes - dhe horizontalisht - ndërmjet të gjithë aktorëve të interesit në qeverisje, biznes dhe në shoqëri në tërësi.

Puna jonë do të mbështetet fuqimisht edhe në bashkëpunimin e ngushtë me donatorët e huaj dhe institucionet ndërkombëtare financiare, prezenca e të cilëve ka qenë e dukshme dhe domethënëse për të gjithë sektorët e veprimtarisë së MPPTT.

Duke përfunduar, do të doja të theksoja se PIM-i i vitit 2008 është programi i dytë i integruar, pas atij të vitit 2007, i përgatitur nga MPPTT dhe do të shërbejë si bazë për hartimin e planeve të tjera të integruara që do të hartohen në vitet e ardhshme. Ai gjithashtu do të shërbejë si një tregues monitorimi dhe vlerësimi i punës së MPPTT gjatë vitit 2008.



Sokol Olldashi

Ministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

## Pasqyra e lëndës

1	Dokumenta strategjike të Ministrisë .....	5
2	Programet buxhetore të Ministrisë .....	14
3	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008.....	17
4	Plani i Monitorimit i Ministrisë .....	25
Aneks 1	Projekt-ligjet për t'u paraqitur.....	26
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Integrimin European .....	29
Aneks 3	Investimet publike .....	312
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj .....	33
Aneks 5	Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit .....	36

# 1 Misioni i Ministrisë

“Misioni i MPPTT është formulimi, zbatimi dhe monitorimi i politikave, programeve, normave dhe standarteve kombëtare për infrastrukturën rrugore, transportet, shërbimet publike, planifikimin hapësinor dhe strehimin, me synim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe promovues për investimet private dhe rritjen ekonomike, duke përdorur burimet e disponueshme në mënyrë sa më produktive, efektive dhe të drejtë”. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit vepron mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe në akte ligjore dhe nënligjore.

Objekti i veprimtarisë së Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në përbërje të strukturës së Qeverisë së Republikës së Shqipërisë është:

- Përgatitja dhe zbatimi i objektivave dhe politikës ekonomike të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin e punëve publike, transportit dhe telekomunikacionit në të gjithë elementet përbërës të tij (infrastrukturë, mjete, operim, etj), në shkallë kombëtare e ndërkombëtare;
- Hartimi i politikave të zhvillimit të punëve publike, transportit rrugor, hekurudhor, detar, ujqor, ajror dhe telekomunikacion dhe ndjekja e zbatimit të këtyre politikave në hallkat e varësisë;
- Përcaktimi i tendencave dhe prirjeve nga analizat e llojeve të punëve publike, transportit dhe telekomunikacionit mbi bazën e statistikave dhe sistemeve të informacionit në ndërtim, transport dhe telekomunikacion dhe hartimi i treguesve makro-ekonomikë të zhvillimit të përgjithshëm të ndërtimit dhe transportit afatshkurtër dhe afatgjatë; hartimi, zbërthimi dhe ndjekja e treguesve të projekt - programeve ekonomike - financiare, të investimeve, etj;
- Grumbullimi i projektplaneve vjetore të njësive shtetërore dhe atyre në varësi të saj për hartimin e projekt-programeve makro ekonomike të degës së ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit për mbikëqyrjen dhe pasqyrimin e parametrave e të treguesve të strategjive të zhvillimit të ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit;
- Negocimi dhe bashkërendimi i punës me Ministrinë e tjera dhe institucionet ndërkombëtare financiare e shtete të ndryshme për sigurimin e burimeve të financimit të domosdoshme, në mënyrë që të krijohen mundësi zhvillimi dhe

harmonizimi të llojeve të ndërtimit dhe transportit, për të mbështetur zhvillimin e ekonomisë së vendit, përmirësimin e lëvizjes së udhëtarëve dhe të kërkesave të transportit evropian;

- Drejtimi, menaxhimi, mbikqyrja dhe vendosja e standarteve teknike të infrastrukturës së rrjeteve rrugore e hekurudhore, të porteve, pontileve e kalatave (në digat e hidrocentraleve) dhe aeroporteve;
- Krijimi i një mjedisi të sigurt pune në Portet e hapura të Republikës së Shqipërisë (porti i Durrësit, Vlorës, Shëngjinit, Sarandës), mjeteve detare që kryejnë veprimtari në këto porte dhe të gjithë përdoruesit e tjerë, duke vendosur kontrole të rrepta të hyrjeve, patrulla në tokë dhe det si dhe duke përdorur pajisjet e vëzhgimit;
- Shqyrtimi dhe propozimi i burimeve të financimit të brendshëm e të jashtëm (me donatorë të huaj) të harmonizuar me burimet ekonomike të ndërtimit dhe transportit për të mbuluar nevojën e zhvillimit të ndërtimit dhe transportit, si dhe rishpërndarja e tyre sipas fushave të ndryshme të veprimtarisë së MPPTT;
- Zhvillimi i hapësirës së iniciativës së lirë private në aktivitetet e shërbimit të llojeve të transportit, si dhe krijimi i kushteve për një konkurrencë të drejtë ndërmjet llojeve të transportit, në veçanti në transportin e udhëtarëve (me autobusë, mikrobusë, taksi e trena), nëpërmjet ndërtimit të sistemit fiskal vetëveprues e deri në hartimin e tarifave tavan, zhvillimin e konkurrencës në sistemin e liçensimit, etj;
- Hartimi i platformës së privatizimit të aktiviteteve të sektorëve përkatës strategjik, si dhe përgatitja dhe krijimi i kushteve për transferimin e pronësisë shtetërore në pronë private;
- Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm ligjor, financiar dhe institucional me synim rritjen e aksesit në strehim të përballueshëm dhe të përshtatshëm me gjendjen ekonomike dhe social shëndetësore të familjeve; ruajtja dhe rritja e vlerës së stokut të banesave;
- Drejtimi dhe synimi për përmirësimin, zgjerimin dhe zhvillimin e shërbimeve të informacionit në ndërtim, transport dhe telekomunikacion për sigurimin e burimit të të dhënave të gjithanshme e të vazhdueshme për drejtimin e ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit, për krijimin e kushteve lehtësuese të të gjithë përdoruesve dhe operuesve vendas e të huaj, si dhe të përshtatshme e të adaptueshme për t'u inkuadruar në sistemet evropiane të informacionit;

- Përcaktimi dhe vendosja e standardeve për të gjithë llojet e mjeteve të transportit dhe organizimi i drejtimit e kontrollit shtetëror të sigurisë teknike në sferën e shfrytëzimit;
- Përcaktimi dhe miratimi i dokumentacionit teknik dhe ekonomik të domosdoshëm për kryerjen e procesit të transportit për të gjithë llojet e mjeteve të transportit;
- Organizimi i kontrollit ekonomik - financiar dhe administrativ në institucionet dhe njësitë ekonomike në varësi të Ministrisë;
- Hartimi i politikës së zhvillimit të burimeve njerëzore të punëve publike, transportit dhe telekomunikacionit si dhe organizimi dhe drejtimi i përgatitjes dhe kualifikimit të specialistëve në sistemin e ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit;
- Zhvillimi i negocimit, kryerjes së përgatitjeve dhe nënshkrimit (me autorizim të organeve kompetente) të marrëveshjeve në fushat e ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit me shtete të ndryshme, duke rregulluar marrëdhëniet ndërkombëtare në bazë të legjislacionit kombëtar e ndërkombëtar, si dhe i referohet rekomandimeve të Komunitetit Europian dhe të organizatave ndërkombëtare të ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit, në të cilët vendi aderon dhe ndjekja e zbatimit të tyre;
- Kryerja e negocimeve për zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit, si dhe përgatitja e domosdoshme për zgjerimin e aderimit të vendit në organizatat ndërkombëtare dhe ndjekja e zbatimit të tyre;
- Përgatitja e një sistemi ligjor e rregullues, sipas kërkesave e standarteve Evropiane;
- Përgatitja e projektligjeve dhe projektakteve nënligjore për përmirësimin e zhvillimit të llojeve të ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit e të shtrirjes së teknologjisë e të standardeve të reja në sferën e operimit të ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit, të rregullave e të standarteve të reja në fushën e teknikës së prodhimit, shërbimit e të mirëmbajtjes së mjeteve të ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit;
- Kryerja, përmirësimi dhe zhvillimi i reformës institucionale në sektorët e ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit, me synim transformimin e përgatitjen shkallë - shkallë të institucioneve në fjalë për të qenë sa më afër standarteve evropiane;
- Hartimi i politikave kombëtare në fushën e planifikimit urban që shërbejnë si bazë në hartimin e kuadrit të plotë ligjor dhe në përmirësimin e mëtejshëm të tij. Koordinimi

e bashkërendimi i punës në fushat e tjera të ekonomisë dhe të pushtetit vendor. Monitorimi, programimi dhe menaxhimi i të gjitha aktiviteteve për zbatimin e programit të Qeverisë për planifikimin territorial, duke respektuar legjislacionin në fuqi;

- Hartimi i politikave të zhvillimit në fushën e qarkullimit dhe sigurisë rrugore, që bëjnë të mundur parandalimin dhe minimizimin e aksidenteve rrugore, nëpërmjet aplikimit të normave dhe standarteve evropiane, të pasqyruara në legjislacionin bazë të transportit rrugor, për të gjithë komponentët me karakter institucional dhe legjislativ, në shërbim të sigurisë së lëvizjes të përdoruesve të rrugës;
- Plotësimi i paketës ligjore dhe rregullatore për zhvillimin e një infrastrukture të komunikimeve elektronike që do t'i shërbejë krijimit të Shoqërisë së Informacionit.

## **2 Dokumenta strategjike të Ministrisë**

### **Strategjia sektoriale e planifikimit urban dhe e strehimit**

Strategjia sektoriale e planifikimit urban është në fazën e hartimit të variantit përfundimtar të saj. Është konsultuar me grupet e interesit si dhe është marrë dhe mendimi i Ministrive duke u reflektuar vërejtjet në të.

### **Strategjia sektoriale e furnizimit me ujë dhe shërbimit të kanalizimeve të ujrave të përdorura**

Strategjia sektoriale e ujit është diskutuar në Komitetin e Planifikimit Strategjik (KPS), është konsultuar me komunitetin e donatorëve dhe grupet e interesit. Në të janë duke u reflektuar komentet dhe sugjerimet e dhëna dhe pritet të mblidhet grupi ndërministror ku do të merren mendimet e institucioneve të tjera të përfshira në këtë sektor. Pas këtij takimi strategjia pritet të përfundojë dhe të paraqitet në variantin e saj përfundimtar për miratim.

### **Strategjia sektoriale e transportit**

Strategjia sektoriale e transportit është diskutuar në Komitetin e Planifikimit Strategjik (KPS) në datën 30 nëntor 2007. Ajo është konsultuar me grupet e interesit si dhe është prezantuar në një takim me donatorët e huaj. Projektvendimi u ka kaluar për mendim ministrive të linjës në datë 20.02.2008

### **Strategjia ndërsektoriale e shoqërisë së informacionit**

Me krijimin e Agjensisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) kompetenca për hartimin e kësaj strategjie i kaloi agjensisë. Tashmë është hartuar një draft i parë dhe janë mbledhur komentet e ministrive të linjës dhe po përpunohet materiali për të pasur një draft të dytë. Gjatë vitit 2008 kjo strategji do të konsolidohet dhe konsultohet me të gjithë aktorët e interesuar. Gjithashtu MPPTT do të fillojë hartimin e Dokumentit të zhvillimit të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë. Ky dokument do të hartohet brenda vitit 2008 në bashkëpunim me konsulencën e parashikuar në kuadër të projektit për bashkëpunim teknik të financuar nga Komisioni Europian dhe të asistuar nga BERZH.

### **Qëllimet**

- Politika e këtij institucioni është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Përmirësimi në vazhdimësi i aftësive drejtuese të stafit të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe niveleve të tjera të vendimarrjes.
- Përafrimi i kushteve të punës me standartet e BE-së.
- Krijimi i një sistemi modern të pagesave dhe kontabilitetit brenda vitit 2010.
- Krijimi i një sistemi informatik që do të sigurojë standartet e nevojshme si në hardware dhe në software për të dhënë të gjithë mbështetjen dhe facilitetin e mundshëm.
- Sigurimi i furnizimit me ujë të pandërprerë në zonat urbane pas vitit 2015.
- Rritja e aksesit në sistemin ujësjellës për zonat urbane deri në 95%, dhe në zonat rurale deri në 81%, parashikuar deri në vitin 2012.
- Rritja e aksesit të furnizimit me ujë nëpërmjet sistemit në 98% për zonat urbane dhe 83 % për zonat rurale, si dhe rritja e aksesit të popullatës për t'u lidhur me sistemin e KUZ 85% për zonat urbane dhe niveli i trajtimit të ujrave të zeza në këto zona me 50%, deri në vitin 2015.
- Përafrimi i kostos së prodhimit të ujit me çmimin e shitjes së tij konsumatorëve.
- Rritja e aksesit të grupeve të ndryshme të shoqërisë për strehim të përshtatshëm, duke synuar deri në vitin 2015 sigurimin e një inventari të konsiderueshëm banesash sociale me qera dhe ndërtimin e 5000 apartamenteve me kosto të ulët në bashkëpunim me sektorin privat.
- Sigurimi i një kuadri ligjor, institucional dhe financiar për mirëmbajtjen e banesave.
- Hartimi i kuadrit të ri ligjor në fushën e planifikimit urban, me qëllim përputhjen me programin e qeverisë, Kushtetutën e RSH dhe akte të tjera ligjore në fuqi.
- Nxitja dhe mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm territorial.
- Hartimi i planeve rregulluese për njësitë vendore të cilat nuk janë pjesë e projekteve të reja;
- Realizimi i legalizimit të ndërtimeve informale.
- Menaxhimi i integruar i zonës bregdetare.
- Eliminimi i 70% të dioksinave dhe furaneve, si ndotësit organik më të rrezikshëm.
- Trajtimi mbi 40% të mbetjeve në landfill (në mënyrë të kontrolluar).

- Transpozimi i direktivave të KE për: trajtimin e makinave jashtë përdorimit, baterive dhe vajrave të përdorur.
- Depozitimi i rreth 20% të mbetjeve të ndërtimit në impiante përpunimi dhe riciklimi; Përmirësimi i punës për të evidentuar në kohë ndërtimet pa leje në të gjithë territorin e Republikës, zbatimi i procedurave ligjore dhe krijimi i kushteve të punës për punonjësit nëpër Drejtori dhe degë.
- Zbatimi i të gjithë afateve dhe procedurave për prishjen e këtyre ndërtimeve.
- Krijimi i kushteve të punës sa më normale për punonjësit në institucion dhe lëvizjen e tyre.
- Krijimi i një infrastrukture rrugore të integruar në planin kombëtar, rajonal dhe paneuropian, synimi final i të cilës është krijimi i një rrjeti unik transporti që do të mbështesë zhvillimin ekonomik.
- Zhvillimi dhe finalizimi i rrjetit baze rrugor (Core Network) i cili mundëson realizimin e korridoreve të transportit rrugor (K.8) e përfshin aksin transnacional Juglindor, korridorin Durrës-Morinë që siguron lidhjen me K.10, aksin Veri-Jug që lejon lidhjen e Greqisë me Malin e Zi nëpërmjet territorit shqiptar (deri në vitin 2011).
- Ndërtimi i rrugës së Arbërit, si degëzim i K.8, e si lidhje më e shkurter midis Shkupit dhe Tiranës (deri në vitin 2013).
- Përmirësimi i mirëmbajtjes së rrjetit rrugor në bazë të Planit Kombëtar të Transportit dhe reformës strukturore në DPRR.
- Rritja e sigurisë së qarkullimit rrugor, reduktimi i aksidenteve rrugore në 50% deri në vitin 2012.
- Rritja e efikasitetit në fushën e transportit.
- Harmonizimi i llojeve të transportit.
- Përafrimi i legjislacionit të transportit me direktivat e BE-së.
- Mbështetje aktive e rritjes së ekonomisë shqiptare, si dhe integrimin evropian të saj, nëpërmjet krijimit të kushteve optimale për eksport - import dhe më gjerë, duke orientuar zhvillimin e porteve nga ekonomia e tregut me një nivel të lartë dhe të sigurt menaxhimi.
- Zhvillimi i Portit të Durrësit sipas modelit Land - Lord Port (Port Administrues Toke).
- Komercializimi i porteve, privatizimi i shërbimeve.

- Plotësimi i standardeve të kërkuara nga Direktiva 2005/ 65/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës për sigurinë në porte dhe anije. Ky qëllim është brenda kostos së parashikuar në PBA 2008-2010.
- Rregullimi i treguesve financiarë nëpërmjet rregullimit të treguesve tekniko-ekonomik.
- Përcaktimi i një manaxhimi të ri të transportit hekurudhor duke përfshirë brenda tij edhe opsionin më të mundshëm të këtij manaxhimi (ndarjet e infrastrukturës nga operimi dhe futjen e biznesit privat në këtë aktivitet, dhënien me konçension dhe shitjen e disa prej shërbimeve).
- Realizimi i planit të biznesit të hartuar mbi bazën e opsionit të vendosur për ristrukturim administrativ për një afat 5 -vjeçar.
- Përmirësimi i gjendjes së infrastrukturës hekurudhore dhe i mjeteve lëvizëse për rritjen e atraktivitetit kundrejt udhëtarëve dhe transportit të mallrave.
- Përfshirja me të drejta të plota e transportit ajror në Zonën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA) dhe në iniciativën "Qielet e Vetëm Evropian"; Harmonizimi i sistemit legjislativ dhe akteve rregullatore të fushës së transportit ajror, me standartet evropiane dhe *acquis communautaire* në këtë fushë.
- Ristrukturimi i strukturave ekzistuese dhe krijimi i entiteve të reja organizative të fushës së aviacionit në përputhje me standartet evropiane të operimit dhe të kontrollit të trafikut ajror.
- Rritja e efikasitetit të aeroporteve dhe operimeve të brendshme dhe rajonale.

**Qëllimet për zhvillimin e sektorit të telekomunikacionit (të cilat nuk janë të përfshira në PBA pasi nuk ka një program të tillë)**

- Zhvillimi i infrastrukturës së telekomunikacioneve që t'i shërbejë tranzitimit drejt Shoqërisë së Informacionit.
- Akses në teknologji dhe mundësi të barabarta për grupe të ndryshme social demografike, qeverisje elektronike jo vetëm për qeverinë por edhe për publikun.
- Ngritja e Autoritetit Rregullator për Shërbimet Postare, në përputhje me standartet evropiane dhe *acquis communautaire*, si dhe amendimet përkatëse në Ligjin Aktual "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë".

- Liberalizimi gradual i Sektorit Postar. Hapja e mëtejshme e tregut me anë të miratimit të parametrave të reja të zonës së rezervuar të Operatorit Publik të Postës.

## 3 Programet buxhetore të Ministrisë

### 3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në implementimin e politikave, të cilat do të bëjnë të mundur përmbushjen e standarteve të vendosura nga BE dhe do të garantojnë përmirësimin dhe përdorimin e vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe financiare, të Ministrisë. Ndërtimi i një sistemi të integruar duke krijuar një ambjent informatik bashkëkohor.

### 3.2 UJËSJELLËS KANALIZIME

Politika e këtij programi konsiston në zhvillimin e infrastrukturës ujësjellës kanalizime për krijimin e shërbimeve efikase të ujit dhe të sanitetit, të krahasueshme me standartet Europiane, në zonat urbane dhe rurale. Kjo do të arrihet nëpërmjet kryerjes së disa reformave në sektor si: *Reforma e Manaxhimit* (manaxhimi i kërkesës, monitorimi dhe krahasimi, kualifikimi i personelit, krijimi i kapaciteteve në sektorin e ujit dhe të sanitetit); *Reforma Ligjore dhe Institucionale* (Reforma institucionale - Ndryshimi i rolit të Qeverisë në sektor nga sigures shërbimi në politikë-bërës, rregullues dhe lehtësues, Reforma Ligjore për procesin e decentralizimit dhe dhënien e kompetencave autoriteteve lokale, Ndërgjegjësimi Publik dhe Programi i Komunikimit); *Reforma e Pjesmarrjes së Sektorit Privat*; Reforma Financiare, Reforma e Zbutjes së Varferisë si dhe Reforma Teknike.

### 3.3 STREHIMI DHE URBANISTIKA

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e një mjedisi të favorshëm ligjor, financiar dhe institucional për zhvillimin e strehimit nëpërmjet: zbatimit të programeve, hartimit të studimeve e rregullimeve ligjore e ofritit të strehimit ( në veçanti për familjet me të ardhura të ulëta), realizimit të skemave të partneritetit shtet privat, ndërtues e bankar dhe hartimit të kuadrit ligjor për funksionimin e bashkëpronësisë në banesa; Hartimi i politikave në fushën e planifikimit urban, kontrollit të territorit dhe përcaktimin e standarteve kombëtare në këtë fushë me qëllim sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm e afatgjatë; Hartimi i kuadrit të ri ligjor në zbatim të politikës; Përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues; Legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i zonave dhe

ndërtimeve informale; Krijimi i menaxhimit të integruar të zonës bregdetare për reduktimin e degradimit të bregdetit nëpërmjet, përmirësimit të politikave rregullatore, investimeve bashkiake dhe komunitare nëpërnjet projektit ICZMCP.

### **3.4 SHËRBIMET PUBLIKE**

Politika e këtij programi konsiston në: përmirësimin e administrimit të mbetjeve, me qëllim që të pakësohen rreziqet ndaj shëndetit të njerëzve dhe mjedisit duke përmbushur kërkesat e KE-së dhe gjithashtu në evidentimin në kohë duke moslejuar ngritjen e ndërtimeve pa leje, prishjen në kohë të tyre dhe zbatimin e procedurave ligjore në hapësirat publike dhe private.

### **3.5 RRJETI I RRUGËVE NACIONALE DHE TRANSPORTI RRUGOR**

Politika e këtij programi konsiston në zhvillimin dhe rehabilitimin e rrjetit rrugor kombëtar, me anën e burimeve të nevojshme financiare, i cili mbështet dhe inkurajon zhvillimin e ekonomisë dhe plotëson kërkesat e transportit Evropian. Me anën e kësaj politike do të zbatohen reformat ekonomike nëpërmjet promovimit të privatizimit të veprimtarive të mbetura dhe vendosjes së sistemit të mbulimit të kostos së ndërtimit nëpërmjet politikave të çmimeve dhe taksave; do të krijohet një sistem rregullator ligjor në përputhje me kërkesat dhe standartet Evropiane, integrimin me legjislacionin Evropian dhe plotësimin e detyrimeve si anëtare e plotë në procesin e Stabilizim Asociimit; do të zhvillohen e zbatohen reformat institucionale mbështetur në sugjerimet e ANTP për sektorin rrugor dhe do të nxitet trafiku i mallrave duke ulur koston e transportit rrugor, aksidentet, bllokimet e trafikut dhe cilësinë e dobët të punimeve.

### **3.6 MENAXHIMI I TRANSPORTIT RRUGOR**

Politika e këtij programi konsiston në kryerjen e studimeve për të përmirësuar dhe zhvilluar transportin detar, hekurudhor, rrugor dhe ajror në drejtim të infrastrukturës, legjislacionit, në përputhje me direktivat e KE-së dhe MSA-së.

### **3.7 PORTET**

Politika e këtij programi konsiston në: Kompletimin e ligjshmërisë kombëtare në fushën e Transportit Detar; Krijimin e Administratës Detare Shqiptare me strukturat përkatëse sipas standardit të IMO; Rritjen e kapaciteteve përpunuese dhe të nivelit të shërbimeve

në portet detare, nëpërmjet rritjes së investimeve në infrastrukturë, superstrukturë dhe nivelit të menaxhimit; Komercializimin e shërbimeve në porte, dhe realizimin me efektivitet të investimeve mbi bazën e Master - Planeve të zhvillimit në perspektivë të porteve; Rritjen e shkallës së sigurisë në portet e hapura të Republikës së Shqipërisë (portet e Durrësit, Vlorës, Sarandës dhe Shengjinit) duke përmirësuar në vazhdimësi legjislacionin kombëtar në përputhje me kërkesat e Kodit të Sigurisë në Porte dhe Anije, si dhe direktivave e rezolutave të Komunitetit Evropian për rritjen e standardeve të sigurisë.

### **3.8 HEKURUDHAT**

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e gjëndjes së infrastrukturës hekurudhore dhe përmirësimin e sigurisë për pasagjerët dhe mallrat që lëvizin në këtë rrjet.

### **3.9 TRANSPORTI AJROR**

Ky program konsiston në zhvillimin e politikave dhe kuadrit ligjor, rregullator dhe operues, për garantimin e efijencës së transportit ajror, sigurisë dhe qëndrueshmërisë, duke ju përgjigjur objektivave të zhvillimit ekonomik të vendit. Gjithashtu ai synon arritjen e standarteve ndërkombëtare nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të infrastrukturës ligjore dhe operuese, përmirësimit të strukturave rregullatore dhe të mbikqyrjes, për arritjen e optimizimit të elementeve të liberalizimit të tregut ajror, sigurisë dhe komoditetit, si dhe lehtësimit të lëvizjes së lirë të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve.

## 4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2008.

### 4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Sigurimi i formimit profesional të stafit, trajnimi i stafit të ri në masën 50% dhe atij ekzistues në masën 35%, në bashkëpunim me ITAP dhe organizma të tjerë, që mund të ofrojnë asistencën e tyre në fushën e transportit, telekomunikacionit, punëve publike, rregullimin e territorit etj.
- Trajnimi në masën 100%, të stafit i cili merret me financat dhe kontabilitetin e Ministrisë së Transportit (Financim i Buxhetit të Shtetit) dhe monitorimi i rezultateve të trainimit.
- Përafrimi i legjislacionit teknik shqiptar dhe përshtatja graduale e rregullave teknike (në kuadër të MSA).
- Informatizimi i procedurave administrative.
- Produktet kryesore që do të ofrohen
- Persona të trajnuar.
- Anëtarësimi në Organizata Ndërkombëtare.

### 4.2 UJËSJELLËS KANALIZIME

Objektivat e politikës

- Rritja e aksesit të popullatës në sistemin e furnizimit me ujë, nëpërmjet investimeve të buxhetit të shtetit apo me financim të huaj, në zonat urbane në masën 92% dhe në zonat rurale në masën 70% duke zbatuar përdorimin e faturës së ujit dhe KUZ si titull ekzekutiv. Kështu për vitin e parë janë parashikuar të investohen 2.545 milion lekë, që synojnë përmirësimin e furnizimit me ujë për rreth 950 mijë banorë dhe rritjen e aksesit të popullatës në zonat urbane 77%, e rurale 52%.
- Sigurimi i furnizimit me ujë në 24 orë në të gjithë zonën turistike.
- Dhënia e subvencioneve ndërmarrjeve të ujësjellësave për të bërë të mundur mbulimin e diferencës midis kostos së prodhimit dhe asaj të shitjes, nëpërmjet një monitorimi mbi bazën e të cilit do të bëhet vlerësimi i tyre për dhënien e subvencioneve.

- Fillimi i aplikimit për përmirësimin e tarifave të reja për sistemin e ujësjellës kanalizimeve.
- Ndërtimi dhe rikonstruktimi i ujësjellësave dhe KUZ në zonat urbane dhe rurale.

Produktet kryesore që do të ofrohen

- Ndërtimi i ujësjellësit të zonës Velipojë.
- Ujësjellësi Shëngjin, furnizimi me ujë i 35`000 banorëve.
- Ujësjellësi i Ksamilit, furnizim me ujë i 37`000 banorëve.
- Ujësjellësi i jashtëm i qytetit Bajram Curri, Furnizim me ujë i 24`000 banorëve.
- Ndërtimi i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit për zonat e plazhit të Durrës - Kavajë nga pus shpimet e Rrogozhinës; furnizim me ujë i 150,000 banorëve dhe turistëve.
- Shtimi i sasisë së ujit dhe sistemimi i lidhjeve të abonentëve në linjën kryesore të ujësjellësit Stacioni i Pompimit Fushë-Krujë-Vorë, furnizim me ujë i 20`000 banorëve dhe turistëve.
- Furnizimi me ujë i 37`800 banorëve të qytetit Kukës dhe të 14 fshatrave rreth tij.
- Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm Krume, furnizim me ujë i 10`000 banorëve.
- Furnizimi me ujë i qytetit Pukë, rrjeti i jashtëm dhe i brendshëm, furnizim me ujë i 11`000 banorëve.
- Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm ujësjellës kanalizime Laç, përmirësimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për 58`000 banorë.
- Ujësjellës kanalizime Mamurras, përmirësimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për 18,000 banorë.
- Furnizimi me ujë i zonës të Kënetës Durrës, furnizimi me ujë i 18`000 banorëve.
- Ujësjellësi Kodër Marlekaj, Bashkia Lezhë, përmirësim furnizimit me ujë dhe i kanalizimeve për 16`000 banorë.
- Rikonstruksioni i ujësjellësit të Rjollit Shkodër, furnizimi me ujë i 48`000 banorëve.
- KUZ në zonën e Kënetës Durrës, ndërtimi i kanalizimeve për 20`000 banorë.
- Furnizimi me ujë i qytetit Peqin, furnizim me ujë i 10`000 banorëve.
- Furnizim me ujë i fshatrave të Bashkisë Sukth, furnizim me ujë i 30`000 banorëve.
- Ujësjellësi rajonal për 8 fshatra të Bashkisë Vorë, furnizim me ujë i 19`170 banorëve.

- Ndërtim ujësjellësi Shkjezë, Komuna Bushat, furnizim me ujë i 1050 banorëve.
- Mbrojtja e Liqenit të Ohrit, komponenti i ujit të pijshëm dhe kanalizime. Ndërtim KUZ i fshatit Tushemisht, bashkëfinancim me KFW-në, ndërtim i kanalizimeve për 550 banorë.

### **4.3 STREHIMI DHE URBANISTIKA**

Objektivat e politikës

- Sigurimi i kushteve për strehimin e rreth 2`000 familjeve
- Përfundimi i studimit dhe planifikimit të integruar të zonës bregdetare jugore
- Përfundimi i kontratave për infrastrukturën në zonën e fshatrave bregdetare
- Fillimi i ndërtimit të landfillit në zonën e Bajkajt
- Fillimi i punimeve për ndërtimin e Terminalit të Sarandës
- Hartimi i kuadrit ligjor për bashkëpronësinë në banesa
- Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit për planifikimin territorial
- Hartimi i Planeve të Përgjithshme Rregulluese të qyteteve: Durrës, Kamëz, Shkodër, Lushnjë, Vlorë, Gjirokaster, Berat, Korçë si dhe studime të tjera urbanistike, sipas kërkesave dhe nevojave të paraqitura nga njësitë vendore
- Përmirësimi i procesit të koordinimit të politikave të planifikimit territorial
- Hartimi i Planit të zhvillimit të bregdetit të Jugut, nëpërmjet përmirësimit të metodologjisë dhe konceptit të planifikimit të zonave bregdetare, që ka për qëllim zhvillimin e integruar të turizmit me aktivitetet social-ekonomike e mjedisore.

Produktet kryesore që do të ofrohen

- Studime dhe projektme urbanistike.
- Mundësi strehimi të lehtësuara për rreth 2 000 familje.

### **4.4 SHËRBIMET PUBLIKE**

Objektivat e politikës

- Hartimi i studimit të fizibilitetit dhe projekt zbatimit për mbylljen e venddepozitimit ekzistues të qytetit të Korçës

- Zbatimi i projekteve prioritare - ndërtimi i fazës së parë të landfillit për Qarkun e Shkodrës dhe Lezhës.
- Hartimi i studimit të fizibilitetit në venddepozitimin ekzistues të qytetit të Beratit.
- Ndërtimi i venddepozitimit të mbetjeve për qytetet Rrëshen dhe Rubik, 6.000.000 lekë
- Transpozimi i legjislacionit të KE-së lidhur me administrimin e makinave jashtë përdorimit.

Produktet kryesore që do të ofrohen

- Përpunimi i 47.000 ton mbetjeve në vit.
- Përpunimi i 3500 ton mbetjeve në vit.
- Rregullore "Për administrimin e makinave jashtë përdorimit.

## 4.5 RRJETI I RRUGËVE NACIONALE

Objektivat e politikës

Këto objektiva mund të ndryshojnë nga parashikimet e bëra gjatë PBA 2008-2010, pasi ato janë modifikuar në përshtatje me buxhetin e miratuar në dhjetor 2007, për vitin 2008.

- Ndërtimi i 168 km rrugë kombëtare kryesisht me dy dhe katër korsi, financim i huaj dhe i brendshëm, gjithsej 53.619 milion lekë (synimi për ndërtimin e segmenteve Milot-Rrëshen, Kalimash-Morinë, Lushnjë-Fier, Tepelenë-Gjirokastrë, mbikalimi i Kamzës, rrugës transballkanike Vlorë, Divjakë, Unaza Shkodër dhe Korçë, si dhe i rrugës së Liqenasit). Rikonstruksioni i 82 km rrugë me dy korsi (sistemimi e asfaltimi i tyre) me financim të buxhetit prej 1,641 milion lekë.
- Ndërtimi i 545 ml ura dhe mbikalime me financim të huaj e të brendshëm gjithsej 736 milion lekë. Rritja e mbështetjes së financimit të brendshëm për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor (prej 3626 km), si dhe fillimi i procesit të privatizimit, bazuar në kontrata performance me shtrirje prej rreth 15 % (rreth 550 km të rrjetit rrugor).
- Realizimi i projekteve për përmirësimin e trafikut dhe të sigurisë rrugore, me financim të buxhetit prej 199 milion lekë, reduktimi i kohës së udhëtimit dhe i aksidenteve në segmentet e përmirësuara me 10%. Sistemimi dhe eliminimi i

rrëshqitjeve të ndryshme në rrjetin rrugor me burim financimi të brendshëm prej 182 milion lekë.

Projektet e rrugëve janë grupuar sipas kategorive. Kështu produktet kryesore që do të ofrohen janë:

- Ndërtim Rrugë Tip A2 (2x2) kors, 53 km
- Ndërtim Rrugë Tip A2' (2x2) kors, 3 km
- Ndërtim Rrugë Interurbane Kryesore Tip B1' (2x1) kors, 70 km
- Ndërtim Rrugë Interurbane Dytësore Tip C2 (2x1) kors, 35 km
- Ndërtim Rrugë Interurbane Dytësore Tip C2' (1x1) kors, 7 km
- Rikonstrukcion Rrugë Tip A2 (2x2) kors, 7 km
- Rikonstrukcion Rrugë Interurbane Dytësore Tip C2 (2x1) kors, 50 km
- Rikonstrukcion Rrugë Interurbane Dytësore Tip C2' (1x1) kors, 25 km

#### **4.6 MENAXHIMI I TRANSPORTIT (INSTITUTI RRUGOR)**

Objektivat e politikës

- Studime mbështetëse për rishikimin e Planit Kombëtar të Transportit, sipas fushave përkatëse.
- Ndjekja e zhvillimit të porteve sekondare (Sarandë dhe Shëngjin) sipas master planeve përkatëse të hartuara nga IST-së.
- Auditimi i infrastrukturës rrugore dhe sinjalistikës në akset rrugore kombëtare.

Produktet kryesore që do të ofrohen

- Studim i kryer për koston e jashtme të transportit.
- Studim dhe implementim i sistemit të informatizuar të rrjetit të linjave interurbane me autobuzë.
- Plani i veprimit për zbatimin e kodit detar.
- Studim mbi unifikimin e dokumentacionit në transportin rrugor.
- Studim mbi sigurinë rrugore për një lëvizje më të sigurtë në të gjithë rrjetin rrugor.

## 4.7 PORTE

### Objektivat e politikës

- Kompletimi i akteve përkatëse ligjore; krijimi i Administratës detare me struktura të plota politikbërëse sipas standardit të IMO-s.
- Vazhdimi i investimeve me buxhetin dhe donatorë të huaj për përmirësimin e infrastrukturës dhe superstrukturës së tyre bazuar në Master - Planet e zhvillimit të porteve.
- Ndërtimi i terminalit të pasagjerëve dhe rikonstruksioni i kalatave 7 e 8 në Portin e Durrësit me financim prej 40 MLN EURO nga BEI, BERZH dhe Qeveria Shqiptare
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe superstrukturës në portin e Vlorës me një financim prej 15,3 MLN EURO nga Kooperacioni Italian.
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe superstrukturës në portet e Shëngjinit dhe të Sarandës, me financim nga Buxheti i Shtetit.
- Përgatitja e akteve ligjore për zgjerimin e Sigurisë në portet e Republikës së Shqipërisë (ky objektiv është i shtuar në krahasim me PBA 2008-2010, por nuk ka kosto shtesë).
- Kryerja e Investimeve të vazhdueshme për pajisjen e forcave të sigurisë në porte me logjistikën e kërkuar, trajnimi i personelit të Autoritetit të Sigurisë në Porte dhe Anije si dhe personelit të forcave të sigurisë në porte (kostot e këtyre aktivitete mbulohen nga vetë të ardhurat e porteve).

### Produktet kryesore që do të ofrohen

- Mbrojtja e tunelit të Komanit nga shembja e gurëve.
- Blerje paisjesh navigacionale dhe komunikimi për kontrollin dhe monitorimin e trafikut.
- Thellimi i pjesshëm i basenit të portit Shëngjin.
- Vazhdimi i ndërtimit të Skoljers Lindore të Portit Shëngjin.
- Thellimi i liqenit të Komanit në kalatën Rajë.
- Kalatë e re për përpunimin e mallrave në portin e Sarandës.

## 4.8 HEKURUDHAT

### Objektivat e politikës

- Përmirësimi i shpejtësisë së lëvizjes së trenave në disa segmente. (nga 30 në 45-50 km/orë)
- Përmirësimi i kushteve në ambjentet e udhëtareve. (shtimi i tetë stacioneve të rinovuara)
- Rritja e sigurisë të lëvizjes së trenave në rrjetin hekurudhor
- Përmirësimi i kushteve të komoditetit të udhëtarëve. (zëvendësimi gradual i vagonave ekzistues me trena të tipit automatrice).
- Përmirësimi i kushteve të mirëmbatjes duke rritur cilësinë dhe shpejtësinë e veprimit.

Pas miratimit të PBA 2008-2010 në muajin gusht deri në miratimin e buxhetit të shtetit në dhjetor 2007, janë bërë disa ndryshime në listën e produkteve që do të ofrohen për arsye edhe të analizës së bërë nga ana e sektorëve vartës të Hekurudhave Shqiptare sha. Pas këtij rishikimi produktet kryesore që do të ofrohen janë:

- Rikonstruksioni i godinave të udhëtarëve në tetë stacione, si Laç, Bajzë, Elbasan, Durrës, Tiranë, Gjorm, etj.
- Blerja e dy trenave të rinj të tipit automatrici.
- Përmirësimi i gjendjes së veprave të artit në zonën e Elbasanit dhe të Durrësit.
- Përmirësimi i gjendjes së linjës hekurudhore nëpërmjet zëvendësimit të 8000 copë traversave në linjën hekurudhore Vorë - Budull dhe vendosjes së çakullit në një gjatësi prej 10 km linjë hekurudhore.
- Hartimi i studimit dhe projekt idesë për lidhjen me linjë hekurudhore të Parkut Energjetik dhe Industrial të Porto Romanos.

## 4.9 TRANSPORTI AJROR

### Objektivat e politikës

- Miratimi Kodit Ajror dhe zbatimi i dispozitave të marrëveshjes ECAA (Faza e parë e protokollit ndërmjet RSH dhe KE).
- Ndryshime strukturore si: kalimi i DPAC-së në Autoriteti i Aviacionit Civil, funksionimi i tij në parametra bashkëkohore dhe me të gjitha fasilitetet e nevojshme sipas standarteve.

- Ruajtja e investimeve të kryera dhe mundësi për vënien në punë të Aeroportit të Kukësit si pjesë e rëndësishme për zhvillimin e transportit të brendshëm në bazë të studimit të trafikut në aeroportin e Kukësit dhe në zonën Vlorë-Sarandë.
- Plotësimi i detyrimeve ligjore dhe financiare që rrjedhin nga antarësimi në organizmat ndërkombëtare të fushës së aviacionit dhe në marrëveshjet shumëpalëshe.

Produktet kryesore që do të ofrohen

- Transformimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil (DPAC), në Autoritet të Aviacionit Civil (AAC).
- Anëtarësimi në Organizatat Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.
- Mirembajtja operative e Aeroportit të Kukësit me qëllim ruajtjen e investimeve të kryera deri në fillimet e operimeve të brendshme ajrore.

**Tabela Buxheti 2008 sipas programeve dhe llojeve të shpenzimeve, milion Lek**

Programet	Pagat dhe kontribute sigurimeve shoqërore 600, 601	e Mallra dhe shërbime 602	dhe Subveconet 603	Të tjera transferta korrente 604, 605	Transferta për buxhetet familiare individët 606	Shpenzime dhe kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	160	74	0	18	30	30	312
Rrjeti i rrugëve nacionale	420	1031	0	100	0	58419	59970
Menaxhimi i Transportit	16	6	0	0	0	11	33
Portet	38	20	0	0	0	1550	1608
Hekurudhat	9	5	450	0	0	360	824
Aviacioni Civil	23	23	0	10	0	40	96
Ujësjellës Kanalizime	44	21	855	0	0	7394	8314
Strehimi dhe Urbanistika	255	100	0	0	120	1459	1934
Shërbimet publike	140	30	0	0	0	180	350
<b>Total</b>	<b>1,105</b>	<b>1,310</b>	<b>1,305</b>	<b>128</b>	<b>150</b>	<b>69,443</b>	<b>73,441</b>

## 5 Plani i Monitorimit i Ministrisë

- Identifikoni dhjetë produktet/treguesit më të rëndësishëm që do të monitorojnë arritjet e ministrisë gjatë vitit 2008.

Treguesit	Njësia	Qëllimi
Mundësi strehimi të lehtësuara	Nr familjesh të ndihmuara	2 000
Zbatimi i projekteve prioritare - ndërtimi i fazës së parë të landfillit për Qarkun e Shkodrës dhe Lezhës. Trajtim në mënyrë të kontrolluar i mbetjeve	ton	47.000 ton mbetje
Aksidentet rrugore, pasojat në njerëz (të vdekur, të plagosur). Përmirësimi i sigurisë rrugore.	nr	10% krahasuar me 2007
Banorë që përfitojnë për herë të parë ujë të pijshëm	nr	400 000
Banorë që do t'u përmirësohet furnizimi me ujë të pijshëm	nr	300 000
Banorë që do të përfitojnë nga ndërtimi i rrjetit të KUZ	nr	170 000
Këto parashikime bëhen bazuar mbi treguesit e viteve 2005, 2006 dhe 2007		
<ul style="list-style-type: none"> <li>rritja e fluksit të pasagjerëve për vitin 2008</li> <li>rritje e numrit të shoqerive ajrore deri në fund të 2008</li> </ul>	Rritja në numrin e fluturimeve	9-10% 1- 2 shoqëri
Plotësimi i rekomandimeve të raportit të vlerësimit nga organizmat ndërkombëtare përgjegjëse për implementimin e legjislacionit, parrezikshmërinë dhe sigurinë në aviacion për vitin 2007 me qëllim që në fund të vitit 2008 të jetë implementuar Plani Rregullues i Veprimit	Nr raportesh	1
Rrugë nacionale të ndërtuara		135 Km
Rrugë nacionale të mirëmbajtura (me performance)	Km	470 Km
Rrugë nacionale të rikonstruara		60 km
Rritja e numrit të pasagjerëve në porte		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Durrës</li> <li>Vlorë</li> <li>Shëngjin</li> <li>Sarandë</li> </ul>		2.7% 7% N/A 10%
Rritja e mallrave		
<ul style="list-style-type: none"> <li>Durrës</li> <li>Vlorë</li> <li>Shëngjin</li> <li>Sarandë</li> </ul>	Rritja në % ndaj nivelit 2007	9% 10% 10% 2%
Hartimi i Planeve Rregulluese të Njësive Vendore	nr	8

## Aneks 1 Projekt-ligjet për t'u paraqitur

- Projektligj “Për ratifikimin e Konventës “ Për menaxhimin e Ujërave të Ballastit dhe sedimenteve të Anijeve”
- Projektligj “Për miratimin e Konventës së UN “ Mbi arrestimin e anijeve, 1989”
- Projektligj “Për miratimin e Konventës Mbi pengjet dhe pretendimet detare”
- Projektvendim në zbatim të Direktivës 96/26/EC të 29 Prillit 1996 “ Rregullat për pranimin në aktivitetin e operatorit të transportit rrugor dhe njohjen reciproke të diplomave, çertifikatave”.
- Projektligj “Për aderimin në Konventën mbi taksimin e mjeteve rrugore që lidhen me transportin ndërkombëtar të udhëtarëve”.
- Projektligj “Për aderimin në Konventën mbi taksimin e mjeteve rrugore që lidhen me transportin ndërkombëtar të mallrave”.
- Projektligj “Për aderimin në Konventën mbi lehtësirat e kalimit kufitar për udhëtimet turistike, nënshkruar në New York më 04.06.1954.
- Projektvendim “Rikategorizimi i disa rrugëve që nuk plotësojnë kushtet e përfshirjes në rrjetin rrugor kombëtar”.
- Projektvendim “Për standardet shqiptare të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve”.
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8102, datë 28.03.1996 “ Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujrave të ndotur”, të ndryshuar.
- Projektvendim “ Mbi metodikën e llogaritjes së qirasë për banesat sociale me qera”.
- Projektvendim “Për miratimin e rregullores për bashkëpronësinë në banesa”.
- Projektudhëzim “Për miratimin e kostos mesatare vjetore të ndërtimit të banesave”
- Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr.8530, dt.23.09.1999 “ Për shërbimin postar në R.SH.”
- Projektvendim “Propozim për projektligjin “ Për komunikimet elektronike në RSH””.
- Projektvendim “Për miratimin e dokumentit të politikës për zhvillimin e telekomunikacioneve në RSH”.
- Projektvendim “Për miratimin e planit të shpenzimeve të ERT-së për vitin 2008”

- Projektvendim “Për miratimin e akteve dhe dokumentave kryesore të Konferencës së të Plotfuqishmëve, Antalia 2006”
- Projektvendim “Për ndryshimin e parametrave të zonës së rezervuar për operatorët publikë postarë”.
- Projektvendim “Për miratimin në parim të Marrëveshjes me Malin e Zi për fushën e postave dhe komunikimeve elektronike”.
- Projektvendim “Për miratimin e Marrëveshjes me Maqedoninë për fushën e postave dhe komunikimeve elektronike”.
- Projektvendim “Për miratimin në parim të Marrëveshjes midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane në fushën e postave dhe komunikimeve elektronike”.
- Projektvendim “Për disa amendime të planit kombëtar të radiofrenkuencave “
- Projektvendim “Për një ndryshim në VKM nr.153, dt 07.04.2000 “ Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor”.
- Projektligj “Për transportin e mallrave të rrezikshme”.
- Projektligj “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”
- Projektvendim “Për krijimin e Entit Kombëtar të Hetimit të Incidenteve dhe Aksidenteve në Aviacionin Civil”.
- Projektvendim “Për organizimin e hapësirës ajrore dhe rregullat e ajrit në RSH”.
- Projektligj “Për njohjen e zbatimin e rregullave unifikuese për kompensimin dhe asistencën ndaj pasagjerëve” (bordingu i mohuar)
- Projektvendim “Për eliminimin e kontrolleve të zbatueshme në kabinë dhe në vendin e mbajtjes së bagazheve në shërbimet e transportit ajror”.
- Projektvendim “Për përcaktimin e orarit të punës në aviacionin civil”.
- Projektligj “Për miratimin përfundimtar të Marrëveshjes, ndërmjet RSH dhe Qeverisë së Sulltanatit të Omanit për shërbimet ajrore, ndërmjet dhe përtej territoreve të tyre.
- Projektligj “Për miratimin përfundimtar të Marrëveshjes ndërmjet RSH dhe Qeverisë së Ukrainës, për shërbimet ajrore”.
- Projektligj “Për punët publike” (Për ndërtimin e objekteve publike)

- Projektvendim “Për miratimin e rregullores për adoptimin e direktivës europiane “ Për sigurimin në punë, në kantieret e ndërtimit”.
- Projektvendim “Për hartimin e rregullave teknike të projektimit për PAK”.
- Projektligj “Për Urdhërin e Inxhinierit” dhe “ Kodin e deontologjisë”.
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar.
- Projektvendim “Për administrimin e territorit të zonës/vendbanimit informal të miratuar dhe prioritetet në trajtim.
- Projektvendim “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme mbi ruajtjen dhe administrimin e informacionit hartografik të përfutur nga fotografimi ajror, dixhital i territorit të Republikës së Shqipërisë”.
- Projektakti “Për miratimin e projekt paketës “Për administrimin e të ardhurave financiare”.
- Projektligj “Për planifikimin territorial”.
- Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit “ Për planifikimin territorial”.
- Projektvendim “Për miratimin e Planit të veprimit financiar dhe institucional në fushën e planifikimit territorial”.

## Aneks 2 Rezultate që lidhen me Integrimin Evropian

- Projekt vendim “Rregullat për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe njohjen reciproke të diplomave dhe certifikatave”.
- Vlerësimi dhe zbatimi praktik i sugjerimeve të dhëna nga studimi zhvillimit të trafikut të brendshëm ajror, nëpërmjet analizave të zhvillimit të trafikut në aeroportin e Kukësit dhe të Zonës Vlorë Sarandë.
- Hartimi dhe miratimi “Standartet Shqiptare të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve”.
- Studim me qëllim njohjen e legjislacionit evropian për përafrimin e legjislacionit të vendit mbi transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë (Dir. 94/55; 96/35; 95/50 EC).
- Trajnime të ekspertëve mbi direktivat që lidhen me transportin e mallrave të rrezikshme, mbi kualifikimin e konsulentëve të transportit rrugor, procedurat uniforme për kontrollet (Dir. 94/55; 96/35; 95/50).
- Ngritja e Kontrollit Shtetëror Portual.
- Perfeksionim i mënyrës së përpunimit dhe publikimit të të dhënave statistikore të aviacionit (pasagjere, posta dhe kargo).
- Studim për aplikimin e tarifave aeroportuale dhe të shërbimit në aeroport.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara “Mbi arrestimin e anijeve”, 1999.
- Projektligj për aderimin në Konventën “Për menaxhimin e Ujërave të Ballastit dhe Sedimenteve të anijeve”
- Projektligj për aderimin në Konventën “Për minimumin e moshës së punësimit të detarëve”
- Ngritja e administratës detare.
- Krijimi i një qendre informimi të trafikut.
- Realizimi i investimeve për përmirësimin e komponentëve të sigurisë rrugore në sinjalistikë rrugore dhe përmirësim i pikave të rrezikut.
- Udhëzim “Për ndryshime në udhëzimin e kualifikimit për drejtues mjeti dhe prog. teoriko praktik”.

- Projekt ligj “Për aderimin në Konventën ‘Mbi taksimin e mjeteve rrugore që merren me transportin ndërkombëtar të udhëtarëve’”.
- Projekt ligj “Për aderimin në Konventën ‘Mbi taksimin e mjeteve rrugore që merren me transportin ndërkombëtar të mallrave”.
- Rregullorja për transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara “Mbi pengjet dhe pretendimet detare”, 1993.
- Studim me qëllim njohjen me legjislacionin komunitar në fushën e transportit rrugor.
- Projekt VKM “Për krijimin e Entit Kombëtar të Hetimit Incidenteve dhe Aksidenteve në Aviacion, si organ i pavarur i aviacionit”.
- Projekt ligj “Në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme”.
- Bashkëpunimi me MPÇSSHB “Mbi harmonizimin e disa ligjeve sociale në lidhje me transportin rrugor” (Rregullore 561/2006).
- Projekt VKM “Për ngritjen, përcaktimin e strukturës, dhe mënyrës së financimit të Autoritetit të Aviacionit Civil”.
- Bashkëpunimi dhe koordinimi, nëpërmjet marrjes së eksperiencave me vende anëtare të BE, të cilat e kanë të konsoliduar këtë praktikë; identifikimi i materialit referues “Për krijimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”.
- Bashkëpunimi dhe koordinimi, nëpërmjet marrjes së eksperiencave me vende anëtare të BE, të cilat e kanë të konsoliduar këtë praktikë; identifikimi i materialit referues “Për organizimin e hapësirës ajrore dhe rregullat e ajrit në RSH”.
- Bashkëpunimi dhe koordinimi, nëpërmjet marrjes së eksperiencave me vende anëtare të BE, në lidhje me përmirësimet e nevojshme që po aplikohen në objektivat e strategjisë kombëtare të furnizimit me ujë dhe shërbimit të kanalizimeve të ujrave të përdorura.

## Aneks 3 Investimet publike

Emërtimi i projektit	Kosto (në milion lekë)
<b>Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi</b>	
Blerje pajisje	8.5
Blerje automjete	10
Rikonstruksion godine	2.5
Studime projektive	9
<b>Rrjeti i rrugeve nacionale</b>	
Ndertim rrugesh	6418
Rreshqitje ne akse nacionale	162
Sistemim asfaltim	1591
Ndertim urash dhe mbikalimesh	245
Garanci objektivesh	50
Supervizion punimesh	314
Studime projektive	327
Ndertim vepra arti dhe siguri rrugore	60
Sinjalistika	224
TVSH dhe kosto lokale	814
Kontigjenca dhe fonde te ngrira	2210
<b>Menaxhimi i transportit (Instituti i Studimeve të Transportit)</b>	
Studime projektive per menaxhimin e transportit	11
<b>Portet</b>	
Investime te reja dhe ne vazhdim	98.4
Studime projektive	1.6
TVSH dhe takse doganore	250
<b>Hekurudhat</b>	
Investime, Rikonstruksione	354
Studime projektive	6
<b>Aviacioni civil</b>	
Investime në Aeroportin e Kukësit	40
<b>Ujesjelles kanalizime</b>	
Investime ne ujesjellesa dhe kanalizime	925.8
Studim Projektive	105.9

Grant konkurues per ujesjellesa dhe kanalizime per pushtetin vendor	1000
Blerje pajisje per Arkivin Qendror Teknik te Ndertimit	2
Kosto lokale	201
TVSH dhe takse doganore	898.3
<b>Strehimi dhe urbanistika</b>	
Enti Banesave	120
Studime	70
Kosto lokale	340
TVSH dhe takse doganore	100

ALUIZNI	30
<b>Sherbimet publike</b>	
Inspektoriati Ndertimor Urbanistik Kombetar	5
Investime ne landfill	152
Studim Projektme	20
Konsulenca, Trajnime	3

## Aneks 4 Projekte të ndihmës së huaj

Emërtimi i projektit	Kosto (në milion lekë)
<b>UJESJELLESA KANALIZIME (TOTAL)</b>	<b>4,261</b>
Periferite Urbane te Tiranës (komponenti infrastrukturor)	338
Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellesit	113
Menaxhimi i mbetjeve Urbane te Tiranës	295
ALB/002 (Maqellare Peshkopi) U. K. per Rajonin e Dibres	7
<b>Projekti i menaxhimit te integruar te ujrave dhe ekosistemit</b>	<b>391</b>
Menaxhimi i projektit, monitorimi dhe vleresimi i tij	0
Projekti Bashkiak i furnizimit me uje	672
Rehabilitimi i furnizimit me uje ne qytetin e Shkodres (faza konsoliduse)	4
Kanalizime Korce (financim i KfË)	140
Rehabilitimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza	0
Mbrojtja e liqenit te Ohrit, komponenti i ujit te pijshem	180
Projekti i kanalizimeve te ujrave te zeza Kavaje	50
Ujesjelles Kanalizime Kruja II	55
Ujesjelles Kanalizime Koplík	33
Mbeshtetje per Rrjetin Hidrik te Tiranës (AT fin.per NUK , Per nderhyrjet e metejshme ne rrjetin ujesjelles kanalizime 20.3 + 32.9 mid IT)	259
Impjanti i pastrimit te ujrave te zeza Vlore	30
<b>Ujesjelles Kanalizime Berat Kucove</b>	<b>82</b>
Ujesjelles Kanalizime Lushnje	421
<b>Kanalizime Korce (Financim i BEi)</b>	<b>250</b>
Ndërtimi i Impiantit të Përpunimit të Ujërave të Zeza	0
Studimi I fizibilitetit te burimeve te Shqiperise se Jugut	25
Faza e dyte (projekti i furnizimit me uje te zonave Rurale Bajze - Rreshen - Klos)	5
<b>Ujesjellesi Vlore (Q.Hollandeze)</b>	<b>255</b>

Ujesjelles Kanalizimeve Fushe Kruje Peshkopi	208
Manskuria Kavaje	101
Nderhyrje te metejshme ne rrjetin Hidrik te Tiranës	2
Furnizimi me uje i zones se Vlores (Orikum, Dukat, Tragjas, Radhime)	36
Ujesjellesi dhe ujrat e perdorura Shkoder	60
Rehabilitimi i sistemit te furnizimit me uje dhe kanalizime ne zonen industriale ne qytetin Shkoder, IPA 2007	50
Rehabilitimi i sistemit te KUZ ne Shengjin, IPA 2007	64
Rehabilitimi i sistemit te kanalizimeve te ne zonen e bregdetit	0
Ndertimi i sistemit te KUZ dhe impianti i trajtimit te ujrave te zeza ne Velipoje, IPA 2007	50
Ndertimi i sistemit te ri te KUZ ne zonen turistike Golem, IPA 2007	50
Ndertim i sistemit te ri te ujrave te zeza ne zonen turistike Golem	50
Ndertimi i sistemit te ri te KUZ ne zonen turistike Durres, IPA 2007	50
Sistemi I ri I KUZ ne zonen turistike Durres	50
Projekti I manaxhimit te Integruar te Ujrave dhe Ekosistemit-bashkefinansim Programi IPA 2008	100
Rehabilitimi i rrjetit te kanalizimeve Sarande	0
Permiresimi i rrjetit te kanalizimeve dhe ndertimi i impiantit trajtimi të ujrave të zeza Vlorë (faza e II), IPA 2008	0
Konsolidimi i projekteve te Veriut (Rurali dhe F.Kruje - Peshkopi)	0
Projekti i kanalizimeve te Tiranës se madhe	0
Korca KfE Kontrata e Re Kredi tregtare	0
Kavaja per Projektin e ri (plotesimi i Impiantit Manskuri dhe Impianti ne Kavaje)	

## Aneks 5 Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit

1. Lidhur me masat që duhet të merren në luftë kundër korrupsionit, në sektorin e mbetjeve të ngurta duhet të ngrihen strukturat që të bëjnë të mundur kontrollin, monitorimin e projekteve si dhe preventimin e ndërtimit të Landfilleve.

2. Ne fushën që lidhet direkt me strehimin momentet që paraqesin rrezik për korrupsion janë:

- Prokurimi i fondeve publike në zërat që janë planifikuar në buxhet, si:
  1. prokurimi i ndërtimit të banesave;
  2. blerja e banesave në treg;
  3. përmiresimi i kushteve të banimit të komunitetit Rom;
  4. përzgjedhja e bankave që do të japin kredi për strehim, në kuadër të subvencionimit të interesave;
- Përzgjedhja e familjeve që do të përfitojnë në një nga programet e strehimit

### Masat për eliminimin e rrezikut

MPPTT nuk prokuron fonde strehimi në mënyrë të drejtëpërdrejtë, por e realizon këtë nëpërmjet EKB, ndërsa në vijim fondet e strehimit do t'u akordohen bashkive. Prokurimi i fondeve bëhet sipas procedurave të ligjit për prokurimin publik dhe masat anti korrupsion janë të njëjta me ato që zbatohen në të gjitha rastet e prokurimit të fondeve publike. Në rastin e blerjes së banesave nga tregu, rreziku i korrupsionit reduktohet, pasi zgjedhja e banesës në treg realizohet nga vetë familja.

Përzgjedhja e familjeve që përfitojnë nga programet e strehimit bëhet nga njësitë vendore, nëpërmjet Komisioneve të Strehimit, ku marrin pjesë edhe përfaqësues të grupeve të prekshme të shoqërisë (si Shoqata e të verbërve të Shqipërisë, Shoqata e Invalidëve, ajo e Jetimeve, etj), dhe me pas kalojnë për miratim në këshillin bashkiak. Kalimi në disa hallka kontrolli ul mundësitë e korrupsionit, por nuk i shmang totalisht ato. Është e nevojshme që subjektet e interesuara të jenë të informuara mbi procedurat, dokumentacionin dhe kriteret për të përfituar strehim nëpërmjet ndihmës shtetërore. Gjithashtu familjet duhet të jenë të informuara mbi programet që janë në zbatim, ose që do të fillojnë të zbatohen (shpesh herë të interesuarit vijnë në Ministri

për t'u informuar ngaqë nuk marrin asnjë lloj informacioni nga bashkitë, apo në rastin më të keq, marrin informacion të gabuar). Ky informacion ndodhet në faqen e internetit të Ministrisë, por jo çdokush tenton të ketë akses në të. Për këtë duhet të parashikohet me ligj detyrimi i bashkive për të informuar me të gjitha mjetet mbi programet e strehimit në komunitetin e tyre.